

VENDIM
Nr. 698, datë 30.10.2019

**PËR HAPJEN E MISIONIT TË POSAÇËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NË KIEV, UKRAINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e Misionit të Posaçëm të Republikës së Shqipërisë në Kiev, Ukrainë.
2. Misioni i Posaçëm në Kiev, Ukrainë, do të ndjekë zhvillimet politike në vend dhe do të pasqyrojë aktivitetin e grupit tripalësh të Kontaktit të OSBE-së për Ukrainën, në kuadër të marrjes së kryesisë së radhës së OSBE-së nga Shqipëria për vitin 2020, deri në mbarimin e kryesisë së radhës së OSBE-së nga Shqipëria.
3. Misioni i Posaçëm do të drejtohet nga një diplomat karriere, me gradën diplomatike “Ministër Këshilltar”, i cili do të qëndrojë në këtë detyrë deri në mbarimin e misionit të posaçëm.
4. Shpenzimet për hapjen e këtij misioni të përballohen nga buxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, miratuar për vitin 2019.
5. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama